

## **RAPORT PËR SHNDËRRIMIN E SHOQËRISË ALBA ROAD NGA SHOQËRIA AKSIONARE (SH.A) NË SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.)**

Unë, Neritan Malo, në cilësinë e administratorit të shoqërisë Alba-Road sh.a, paraqes këtë raport të hollësishëm në të cilin përshkruhet:

- Baza ligjore dhe ekonomike për shndërrimin e shoqërisë Alba Road sh.a nga një shoqëri aksionare (sh.a) në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k);
- Vështirësitë e vecanta të vlerësimit mbi shndërrimin (nëse janë hasur)
- Efektet që do të sjellë ky shndërrim i formës ligjore të shoqërisë ndaj punëmarrësve

### **1. Përshkrim**

Shoqëria Alba Road sh.a është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 29/09/1998, me NUIS J83211208W dhe seli qendrore në Ish Kombinati Metalurgjik, zone kadastrale nr.3965, nr.pasurie 913, Elbasan. Shoqëria ka një kapital prej 320,000,000 lekë, të ndara në 320,000 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili dhe është e zotëruar nga katër aksionarë: Neritan Malo, 30% të kapitalit, Konstantinos Ydraios, 30% të kapitalit, Stylianos Ydraios, 30% të kapitalit dhe Mirela Malo, 10% të kapitalit.

Alba Road është e organizuar si shoqëri aksionare me dy nivele, struktura organizative e së cilës përbëhet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori si përfaqësues ligjor i shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë është: Import eksport materiale ndertimi, lende te para etj. Prodhim, perpunim polisteroli. Tregtim me shumice e pakice te produkteve termoizoluese, hidroizoluese. Punime speciale ndertimore me materiale termo e hidroizoluese. Pjekje bluarje e tregtim i kafese. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmes që ka si qëllim ofrimin e cdo shërbimi tjetër dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor. Me qëllim realizimin e objektit të saj, me vendim të Asamblese së Përgjithshme, Shoqëria mund të zotërojë në mënyrë të drejtperdrejte ose të terthorte, aksione ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja. Shoqëria, me miratimin e Organit të Administrimit dhe me qëllim realizimin e objektit të saj, mund të marrë pjesë në çfaredolloj marrëveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqëri dhe ndërmarrje të tjera si edhe të kryejë çdo akt tjetër të nevojshëm. Shoqëria mund të lidhë kontrata qiraje, shitblerje, marrëveshje për vendosje hipoteke mbi pasuri të paluajtshme, marrëveshje huadhenie ose financimi, marrëveshje për ofrimin e shërbimeve dhe çdo marrëveshje tjetër që konsideron të nevojshme dhe/ose të dobishme për përmbushjen e objektit të saj. Transport të mallrave për nevoja të aktivitetit dhe transport të punonjesve.



## 2. Baza ligjore

Procesi i shndërrimit të shoqërisë në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, bazohet në dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, e përkatësisht të neneve 228, 229 si dhe 221, 222, 223, 224 të ligjit si dhe ligji nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar.

Ky shndërrim i formës ligjore nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

## 3. Arsyet e transformimit

Transformimi i shoqërisë nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar po kryhet për nevojat operacionale të shoqërisë si dhe për mirëadministrimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë Alba Road, e cila në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, mund të kryhet nga subjekte tregtare të strukturuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

## 4. Baza dhe pasojat ekonomike

### *i. Ndikimi i shndërrimit mbi kapitalin e regjistruar dhe pjesëmarrjen:*

Kapitali aktual aksionar i shoqërisë është prej 320,000,000 lekë, të ndara në 320,000 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili dhe është e zotëruar nga katër aksionarë:

Neritan Malo, 30% të kapitalit, Konstantinos Ydraios, 30% të kapitalit, Stylianos Ydraios, 30% të kapitalit dhe Mirela Malo, 10% të kapitalit.

Kapitali është i përbërë tërësisht nga kontribute në para dhe është i shlyer nga aksionarët e shoqërisë. Kapitali do të vazhdojë të zotërohet nga po të njëjtët individë, në përputhje me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapital. Në vijim të shndërrimit në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, do të jenë në cilësinë e ortakëve, duke zotëruar 1 (një) kuotë secili në përputhje me pjesëmarrjen në kapital si më poshtë:

1. Neritan Malo, titullar i 1 (një) kuote, me vlerë 96,000,000 lekë, që përbën 30 % të kapitalit të shoqërisë
2. Konstantinos Ydraios, titullar i 1 (një) kuote, me vlerë 96,000,000 lekë, që përbën 30 % të kapitalit të shoqërisë
3. Stylianos Ydraios, titullar i 1 (një) kuote, me vlerë 96,000,000 lekë, që përbën 30 % të kapitalit të shoqërisë
4. Mirela Malo, titullare e 1 (një) kuote, me vlerë 32,000,000 lekë, që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë

### *ii. Ndikimi i shndërrimit mbi kërkesat për kapital minimal*

Në vijim të shndërrimit të shoqërisë nga sh.a në sh.p.k, kjo e fundit nuk do të ketë më detyrimin ligjor për ruajtjen e kapitalit minimal neto në jo më pak se 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë në përputhje me parashikimet e Nenit 105 të ligjit për kapitalin minimal të shoqërive aksionare.

*iii. Ndikimi i shndërrimit mbi rezervat ligjore dhe rezerva të tjera*

Bazuar në parashikimet e nenit 127 të ligjit tregtar, Alba Road ka krijuar rezerva ligjore në shumën aktuale prej 17.610.510 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dhjetë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë krijuar nga fitimi pas tatimit në periudhat paraardhëse.

Bazuar në parashikimet e statutit, Alba Road ka krijuar rezerva statutore në vlerën 4.700.000 (katër milion e shtatëqind mijë) lekë.

Shoqëria do të vazhdojë t'i ruajë këto rezerva ligjore dhe statutore në rezerva të tjera, deri në orientime të reja në periudhat vijuese.

Kjo rezervë do të vazhdojë të mbetet e tillë.

*iv. Ndikimi i shndërrimit mbi të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë*

Shndërrimi nuk do të ndikojë dhe as nuk shkakton asnjë efekt apo ndryshim të të drejtave dhe përgjegjësisive të shoqërisë ndaj të tretëve, të regjistruara rregullisht në librat e shoqërisë sipas parashikimeve të standardeve të aplikueshme të kontabilitetit si dhe sipas kërkesave të Ligj nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

*v. Ndikimi i shndërrimit mbi raportimin financiar dhe auditimin ligjor të pasqyrave financiare*

Në vijim të shndërrimit nga sh.a në sh.p.k dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit për Kontabilitetin, Ligjit për Auditimin Ligjor si dhe akteve të tjera nënligjore, shoqëria do të vazhdojë të përgatisë pasqyrat e saj financiare mbi bazat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar(SNRF).

Bazuar në parashikimet e Ligjit për Auditimin Ligjor, shoqëritë tregtare, pavarësisht formës ligjore, të cilat zbatojnë SNRF për qëllime të raportimit financiar kanë detyrimin të kryejnë auditim ligjor të pasqyrave financiare vjetore.

Në vijim të këtyre parashikimeve, Shoqëria do të vazhdojë të auditojë pasqyrat financiare edhe pas shndërrimit në sh.p.k.

**5. Efektet e shndërrimit tek punëmarrësit dhe organet drejtuese të shoqërisë**

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë do të shpërbëhet dhe anëtarët e tij nuk do të mbajnë më këtë funksion nga data e përfundimit të regjistrimit të shndërrimit.

Shndërrimi nuk do të ndikojë në marrëdhëniet e punësimit ndërmjet Alba Road dhe punëmarrësve të saj duke qenë se nuk ka efekte mbi kontratat e punës apo mbi aktivitetin tregtar të zakonshëm të shoqërisë.

**6. Efektet ligjore të shndërrimit**


Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të ketë efektet ligjore si më poshtë:



- a) Shoqëria që shndërrohet të vazhdojë të ekzistojë në formën ligjore të përcaktuar në vendimin e shndërrimit
- b) Aksionari/ortaku i shoqërisë që shndërrohet vazhdon të marrë pjesë në shoqëri sipas kushteve të përcaktuara në ligj për formën e re të shoqërisë: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
- c) Të drejtat e personave të tretë për aksionet e shoqërisë që shndërrohet vazhdojnë të zbatohen dhe për kuotat e shoqërisë së shndërruar

Administratori

z.Neritan Malo



Data: 18.12.2023

